



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Gjeokonsult & Co" të datës 31.08.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "100 Ndërtimi i sheshit Xhorxh Bush" me nr. të prokurimit 616-24-8261-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET si pjesërisht e bazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Gjeokonsult & Co" të datës 31.08.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "100 Ndërtimi i sheshit Xhorxh Bush" me nr. të prokurimit 616-24-8261-5-1-1.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të publikoj Formularin për Korigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara përmes të cilit do të bëj korigjimin e kërkesave në dosjen e tenderit sipas të gjeturave të evidentuara më poshtë në këtë vendim.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Gjeokonsult & Co" (tutje "parashtruesi") me datë 31.08.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "100 Ndërtimi i sheshit Xhorxh Bush" me nr. të prokurimit 616-24-8261-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Pretendimi nr. 1 – *“Ne baze te vleres se parashikuar te projektit dhe te paramases se publikuar, eshte evidente se kemi te bejme me nje projekt kompleks, oferta e te cilit duhet analizuar hollesishem per te pergaditur nje oferte serioze. Fakti se afati i caktuar nga Autoriteti Kontraktues per dorezimin e ofertave per nje periudhe prej 23 dite, eshte i jashteligjshem eshte edhe jo-serioz”*.

Lidhur me këtë pretendim duhet sqaruar se për këtë aktivitet të prokurimit është publikuar njoftimi paraprak për kontratë. Megjithatë sipas nenit 44 dhe 45 të LPP përcaktohet se afati për dorëzimin e ofertave në aktivitetet e prokurimit për të cilat është publikuar njoftimi paraprak për kontratë, duhet të jetë së paku 24 ditë. Prandaj pretendimi ankimor është i bazuar në pikën ku thuhet se afati për dorëzim të ofertave nuk mund të jetë 23 ditë. Rrjedhimisht AK duhet të publikoj formularin për korrigjimin e gabimeve njoftimet e publikuara përmes të cilit do të bëj zgjatjen e afatit për dorëzimin e ofertave për këtë aktivitet të prokurimit.

Pretendimi nr. 2 – *“Kompania jone ka te punesuar mbi 30 inxhinier te fushave te ndryshme, me pervoja relevante per projektin ne fjale, por kerkesat e vendosura nga Autoriteti Kontraktues lidhur me certifikata per mbrojtje nga zjarri, tuba W400, ISO 9001 jane te pa-arsyeshme. Ne sigurisht e kuptojme rendesine e sigurise ne pune dhe kontrollit te cilesise, dhe AK ka te drejte qe te kerkoje qe ne staf te kete persona te certifikuar per siguri ne pune dhe mbrojtje nga zjarri, por asesi, AK nuk ka te drejte qe te percaktoje nese keto certifikimi duhet ti kete menaxheri i projektit apo ndonje inxhinier tjetër i caktuar”*.

Lidhur me këtë pretendim duhet sqaruar se të gjitha kërkesat e DT sa i përket standardeve të cilësisë dhe/apo certifikimet tjera përkatëse, janë hartuar me kujdes duke marrë parasysh kompleksitetin dhe natyrën e projektit. Në rastin konkret kërkesat për stafin e operatorit ekonomik tenderues janë të gjitha kërkesa apsolutisht të domosdoshme. Mospërmbushja e secilës prej tyre do të rrezikonte në mënyrë thelbësore jo vetëm cilësinë dhe nivelin profesional të projektit në fazën e implementimit, por edhe efikasitetin dhe efektivitetin e realizimit të projektit si të tillë. Prandaj pretendimi ankimor është i pabazuar në tërësi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pjesërisht pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar vetëm pjesërisht.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP.

Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 04.09.2024



Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.